



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201460/13

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandim për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit lidhur me shtetasin B.L. dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Me shkresën nr. K2/B12-11 prot., datë 09.05.2023, ju bëmë me dije se me shkresat nr. K2/B12-5 prot., datë 31.01.2023; nr. K2/B12-6 prot., datë 24.02.2023 dhe nr. K2/B12-9 prot., datë 04.04.2023, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Vlorë, e kemi vënë në dijeni këtë organ lidhur me ankesën e bërë në institucionin e Avokatit të Popullit nga shtetasi B.L., lindur më 14.11.1995 dhe banues në fshatin Vllahinë të bashkisë Selenicë. Ankuesi ndërmjet të tjerave shkruan se ka kandiduar për t'u punësuar në Gardën e Republikës dhe pas konkurimit është shpallur fitues. Por, pas shpalljes së rezultateve të konkurimit ai është skualifikuar dhe nuk është pranuar në strukturat e Gardës së Republikës sepse vërtetimi i besueshmërisë së tij i bërë nga Komisariati i Policisë Vlorë dhe konkretisht oficeri i policisë gjyqësore Edvin Habazaj është negativ.

Sipas ankuesit, ai nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe morale për t'u punësuar në strukturat e Gardës së Republikës, sepse nuk ka kryer asnjë vepër penale, nuk është i dënuar penalisht, apo që në ngarkim të tij të jetë i hapur ndonjë proces penal në organet e prokurorisë dhe gjykatës. Këtë fakt ai e provon me dokumentacionin e marrë në këto organe të cilin e ka dorëzuar së bashku me kërkesën e aplikimit.

Ankuesi pretendon se nga ana e Komisarariatit të Policisë Vlorë i është bërë një padrejtësi sepse ai i plotëson të gjitha kriteret për të qenë i besueshëm dhe për t'u punësuar në strukturat e Gardës së Republikës.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën nr. K2/B12-2 prot., datë 20.12.2022, drejtuar Komisarariatit të Policisë Vlorë i kërkuam që të na dërgonte një informacion lidhur me pretendimet e ankuesit dhe se cilat janë shkaqet e përpilimit negativ të vërtetimit të besueshmërisë së tij për t'u punësuar në strukturat e Gardës së Republikës. Gjithashtu i kërkuam që të na informonte se çfarë informacione e materiale ka në ngarkim të shtetasit B.L. nga strukturat e Policisë Kriminale të Policisë së Shtetit që cenojnë besueshmërinë e tij.

Komisariati i Policisë Vlorë me shkresën nr. 7239/1 prot., datë 28.12.2022 ndërmjet të tjerave na informoi se nga Seksioni i Analizës dhe Informacionit Kriminal, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, me shkresën nr. 2221/1, datë 20.10.2022, i është kthyer përgjigje se nga analizimi i të dhënave të grumbulluara, ky shtetas ka pengesa ligjore për të ushtruar veprimtarinë e kërkuar nga ana e Gardës së Republikës, pasi është i evidentuar në Kartotekën e Hetimit të Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë.

Në vijim të ndjekjes së kësaj ankese, më datë 31.01.2023 e në vijim me kërkesë të përsëritur më datë 24.02.2023, i kërkuam DVP Vlorë që të na dërgonte një informacion lidhur me informacionet dhe materialet që administrohen në Kartotekën e Hetimit të Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë apo strukturat e Policisë Kriminale të Policisë së Shtetit në ngarkim të shtetasit B.L. që cenojnë besueshmërinë e tij.

Ndërkohë në këtë shkresë i bëmë me dije se punonjësi i institucionit tonë që trajton këtë ankesë është i pajisur me Certifikatën e Sigurisë së Personelit të lëshuar nga organi kompetent sipas akteve normative në fuqi.

Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes kaloi, ajo nuk na u kthye. Moskthimi i përgjigjes ka sjellë si pasojë moskorrektesën e institucionit tonë ndaj ankuesit për shqyrtimin e ankesës së tij brenda afatit ligjor. Ndërkohë si rrjedhojë e kësaj është cënuar edhe reputacioni i Avokatit të Popullit në publik.

Ndodhur në këto rrethana, për të zgjidhur këtë ngërç, në datën 23.03.2023 Nd/Komisioneri i institucionit tonë z. Sotiraq Nushi, i cili është ngarkuar me shqyrtimin e kësaj ankese, shkoi në DVP Vlorë dhe mori takim me Zv/Drejtorin z. Elton Alushi. Ai e informoi se e kishte deleguar për ndjekje kërkesën tonë, dhe nga punonjësi i ngarkuar po përgatitej përgjigja e kërkuar.

Ndihmëskomisioneri e informoi z. Alushi për të drejtën ligjore që ka institucioni i Avokatit të Popullit dhe punonjësit e tij për t'u njohur e marrë dokumente të klasifikuara dhe ndërkohë i paraqiti atij edhe Certifikatën e Sigurisë së Personelit të lëshuar nga autoriteti kompetent DSIK-ja. Z. Alushi e vuri në dijeni atë se do të dërgonte përgjigjen

e kërkuar, por jo informacionin e administruar ndaj shtetasit B.L. dhe se nuk do të krijonte mundësinë e njohjes së tij Nd/Komisionerit të institucionit tonë.

Pas këtij takimi, me shkresën nr. 1262/1 prot., datë 24.03.2023, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë ndërmjet të tjerave na informoi si më poshtë:

“Policia e Shtetit, për realizimin e veprimtarisë së saj në zbatim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, zbaton edhe “mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, bazuar në nenin 124 të tij, të dhëna të cilat administrohen në dosje dhe në sistemet elektronike të Policisë së Shtetit dhe janë të klasifikuara “Sekret shtetëror”.

Dokumentacioni që ju kërkonte, në bazë të Vendimit të Ministrit të Brendshëm nr. 2, datë 08.04.2022, “Lista e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Policinë e Shtetit dhe strukturat në varësi të saj” është klasifikuar “Sekret” dhe deri në momentin e deklasifikimit të tyre nuk mund t’ju vihen në dispozicion.

Referenca ligjore është ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, neni 21, “E drejta e njohjes së informacionit”.

Nga përgjigjja e cituar më sipër rezulton se refuzimi i DVP Vlorë për të na vënë në dispozicion dokumentet në ngarkim të shtetasit B.L., të cilat administrohen në Kartotekën e Hetimit të Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, bazohet në nenin 21 “E drejta e njohjes së informacionit”, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar.

Duke vlerësuar se përgjigjja e dërguar nga DVP Vlorë nuk ishte e bazuar në ligjin në të cilin referohej, me shkresën nr. K2/B12-9 prot., datë 04.04.2023, i kërkuam këtij organi bashkëpunim për dërgimin e informacionit të kërkuar, duke argumentuar të drejtën ligjore të institucionit të Avokatit të Popullit për t’u njohur edhe me dokumente e informacione të klasifikuara. Por edhe pas kësaj, nga DVP Vlorë nuk pati ndonjë reagim pozitiv. Ndonëse tej afatit ligjor, formalisht na u dërgua një përgjigje me të njëjtat arsytetime jo të qenësishme sikurse ishte bërë edhe më parë.

Theksojmë se qëndrimi mosveprues i DVP Vlorë ka penguar institucionin e Avokatit të Popullit për të kryer misionin e tij kushtetues dhe ligjor për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve dhe konkretisht të shtetasit B.L..

Mosdërgimi nga ky organ i informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën një rast tipik të mosbashkëpunimit të një organi të administratës publike me institucionin kushtetues të Avokatit të Popullit.

Për këto arsye, me shkresën nr. K2/B12-11 prot., datë 09.05.2023, kërkuam ndërhyrjen tuaj në cilësinë e organit epror të DVP Vlorë, për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij

ngërçi subjektiv për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit në ngarkim të shtetasit B.L..

Ndërkohë, bazuar në nenin 22/1 “Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit” të ligjit organik “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*, në këtë shkresë ju kërkuam edhe fillimin e procedurës administrative ndaj drejtorit të DVP Vlorë z. Ermal Muçaj.

Ju me shkresën nr. 1206/10 prot., datë 26.05.2023 na informuat se:

“Referuar nenit 28 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, ku përcaktohen kriteret për njohjen me informacionin e klasifikuar, të cilat janë:

a) sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit;

b) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë; dhe

c) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”.

Nga ana juaj kërkohet pajisja me autorizim nga Ministri i Brendshëm për t’ju vënë në dispozicion materialet në ngarkim të shtetasit B.L., të cilat gjenden në kartotekën për hetimin e krimeve në DVP Vlorë”.

Nga përgjigjja juaj të cilën e cituam më sipër rezulton se, pengesa për të na vënë në dispozicion materialet e kërkuara është mos pajisja jonë me autorizim nga Ministri i Brendshëm dhe se për këtë arsye kërkoni pajisjen tonë me këtë dokument.

Ndërsa lidhur me kërkesën tonë për fillimin e procedurës administrative ndaj drejtorit të DVP Vlorë z. Ermal Muçaj, nuk na dërguat asnjë informacion.

Ndodhur në këto rrethana faktike e ligjore si dhe nxitur nga përgjigjja juaj vlerësojmë të nevojshme që të risjellim në vëmendjen tuaj, se Avokati i Popullit është një institucion kushtetues i parashikuar në nenet 60 deri 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Organizimi dhe funksioni i tij është rregulluar me ligjin organik nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

E drejta e institucionit të Avokatit të Popullit për të kërkuar informacion nga organet e administratës publike, pjesë e të cilës është edhe Policia e Shtetit, bazohet në nenin 63, pika, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.*

Gjithashtu kjo e drejtë bazohet edhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar dhe konkretisht nenin 19, gërma "b", ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*.

Përveç sa më sipër theksojmë se Avokati i Popullit ka mandat të vlerësojë rregullshmërinë e veprimtarisë së strukturave dhe institucioneve të sigurisë. Ky mandat është parashikuar në nenin 31 të ligjit organik "Për Avokatin e Popullit" ku përcaktohet se:

"Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në pesë seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët.

Këto seksione janë:

- 1. Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.*
- 2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.*
- 3. Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues.*
- 4. Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.*
- 5. Seksioni i përgjithshëm.*

Në varësi të nevojave të institucionit, Avokati i Popullit vendos që pranë seksioneve të ngrihen dhe të funksionojnë nënseksione të posaçme, të cilat përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit."

Përjashtimi i vetëm sa i përket mandatit të Avokatit të Popullit është parashikuar në nenin 25 të këtij ligji, sipas të cilit:

"Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit personat dhe aktet e mëposhtme:

- a. Presidenti i Republikës*
- b. Kryetari i Këshillit të Ministrave*

Gjithashtu, janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit:

Urdhrat me karakter ushtarak të Forcave të Armatosura...."

Nga interpretimi i këtyre dispozitave, si asaj kushtetuese, nenit 63/4 dhe asaj të ligjit organik, nenit 19/b, kuptohet në mënyrë të qartë se institucioni i Avokatit të Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime dhe informacione nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin administrativ të ankesave, kërkesave dhe rasteve të filluara me nismën e vet. Ndërkohë është më se e qartë që organet e administratës publike janë të detyruara t'i japin institucionit të Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij pa vendosur asnjë lloj kufizimi, kuptohet ato që lidhen me objektin e misionit të vet dhe të kërkesës apo ankesës që trajton, sikurse është edhe rasti në fjalë/shqyrtim i ankesës së shtetasit B.L..

Përfshirja në ligjin organik të Avokatit të Popullit të një dispozite të veçantë, nenit 20, lidhur me informacione apo dokumente të klasifikuara si “Sekret shtetëror” është një veçanti dhe përbën specifikë kushtëzuese për informacionet dhe dokumentet e klasifikuara si të tilla.

Në nenin 20 të këtij ligji i emërtuar “E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore” parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”.¹

Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se kushtëzimi ligjor i institucionit të Avokatit të Popullit qëndron në fjalinë e dytë të saj e cila parashikon dhe sanksionon se, në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror. Pra, ky kushtëzim detyruës duhet përmbushur me qëllim që institucioni i Avokatit të Popullit (Avokati i Popullit dhe punonjësit e tij) të njihet dhe të marrë informacione e dokumente të kësaj natyre, të klasifikuara “Sekret shtetëror”.

Ndërkohë kjo pjesë përbërëse e kësaj dispozite të referon tek aktet normative në fuqi të cilat kanë si objekt, fushë veprimi dhe qëllim, vendosjen e rregullave të detyrueshme për ruajtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Akte normative në fuqi të cilat kanë si objekt të tyre vendosjen dhe zbatimin e detyrueshëm të rregullave në fushën e sekretit shtetëror janë:

1. Ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, i cili është publikuar/botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 22.02.2023 dhe ka hyrë në fuqi në datën 10.03.2023.

Referuar nenit 1 të tij, *objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë dhe i rregullave për krijimin, administrimin, deklasifikimin, zhvlerësimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të tij.*

Sipas nenit 3 të tij, *ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë për të cilët për ushtrimin e detyrave të tyre dhe bazuar në parimin “nevojë për njohje” kërkohet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar.*

SKI-të sipas këtij ligji nuk përjashtohen nga detyrimet që rrjedhin nga fusha e veprimit të legjisllacionit në fuqi që rregullon sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë, si pjesë e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Në nenin 27 “Siguria e personelit” parashikohet se:

¹ Sjellim në vëmendje që ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, është ligj që miratohet me shumicë të cilësuar.

“1. Siguria e personelit është tërësia e masave dhe procedurave, mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një individ, duke iu referuar besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar, pa rrezikuar sigurinë e këtij informacioni.

2. Lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së sigurisë së personelit” bëhet nga AKSIK-ja.

3. Kur ekspozohet informacioni i klasifikuar apo për shkak të një kushti, të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, arsyet e refuzimit, pezullimit të përkohshëm apo heqjes së CSP-së nuk i bëhen me dije individit, institucionit kërkues apo operatorit ekonomik.

4. Procesi i verifikimit të sigurisë vijon edhe pas pajisjes së aplikantit me CSP. Kjo përfshin vlerësim të vazhdueshëm sigurie për çdo ndryshim në sjelljen e individit, që e bën atë të cenueshëm nga pikëpamja e besnikërisë, besueshmërisë dhe e sigurisë së tij.

5. Rregullat e detajuara për sigurinë e personelit përcaktohen në rregulloren që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Ndërsa, në nenin 28 të tij me titull “Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar” përcaktohet se:

“1. Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm personat, që:

a) sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit;

b) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë; dhe

c) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”.

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit janë të autorizuar që të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar për shkak të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare e pajisen me CSP pa iu nënshtruar procedurave të verifikimit të sigurisë”.

Më tej, në nenin 64 të tij “Detyrat e Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar” (AKSIK) parashikohet si vijon:

“AKSIK-u, në zbatim të misionit të tij, kryen dhe realizon këto detyra:

a) përgatit projektaktet nënligjore për çështjet që lidhen me sigurinë e informacionit të klasifikuar;

b) përcakton rregullat për elementet e sistemeve që administrojnë informacion të klasifikuar dhe bën rekomandime për përshtatshmërinë e tyre;

c) mbikëqyr dhe inspekton rregullat e sigurisë për informacionin e klasifikuar;

ç) monitoron proceset e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe lëshon rekomandime për vendosjen e praktikave të standardizuara;

d) kryen certifikimin e personelit, i cili do të administrojë informacionin e klasifikuar;

dh) kryen akreditimin e sigurisë së sistemit në të cilin prodhohet, administrohet, përpunohet dhe ruhet informacioni i klasifikuar;

e) kryen certifikimin e operatorëve ekonomikë me CSI-në;

ë) inspekton operatorët ekonomikë në lidhje me zbatimin e masave të sigurisë të informacionit të klasifikuar;

f) rekomandon marrjen e masave për përmirësimin e punës në rastet e mangësive apo parregullsive në fushën e informacionit të klasifikuar;

g) rekomandon marrjen e masave dhe vendos masa administrative individuale në rastet kur konstatojnë shkelje të rregullave të sigurisë së informacionit të klasifikuar kur këto rekomandime nuk plotësohen;

gj) shqyrton kërkesat për autoritet klasifikues nga institucione që nuk e kanë atë dhe, nëse është e përshtatshme, ia propozon për miratim Kryeministrit;

h) bashkëpunon me NATO-n, BE-në dhe me autoritetet kompetente të vendeve anëtare të këtyre organizatave për fushën të cilën mbulon;

i) merr pjesë dhe përgatit projekt marrëveshjet mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar me shtete apo organizata të tjera ndërkombëtare;

j) trajnon personelin që punon me informacion të klasifikuar”.

Ndërsa në nenin 79 “Nxjerrja e akteve nënligjore” parashikohet se:

“1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, pika 4; 18, pika 4; 19, pika 5; 20, pika 3; 22, pika 7; 24, pika 2; 26, pika 3; 27, pika 5; 36, pika 3; 37, pika 5; 38, pika 3; 45, pikat 3 dhe 4; 46, pika 2; 49, pika 3, dhe 50, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet AKSIK-u të nxjerrë udhëzimin mbi procedurat në zbatim të rregulloreve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Aktet nënligjore, të miratuara në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore për sa kohë nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji.”

2. Në vijim të nenit 31 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, janë nxjerrë dhe miratuar disa VKM. Sqarojmë se, ndonëse ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 është shfuqizuar nga neni 80 i ligjit nr. 10/2023, referuar nenit 79/3 të ligjit të ri të cituar më sipër, ato janë ende në fuqi deri në miratimin e akteve të reja. Ndërmjet akteve nënligjore, po i referohemi VKM-ve të mëposhtme:

- **VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e personelit””**

Sipas nenit 1, objekti i kësaj rregulloreje është:

“a) përcaktimi i rregullave për zhvillimin e procedurave të verifikimit të sigurisë ndaj individëve që do të njohin, do të prodhojnë, do të ruajnë, do të administrojnë, do të

transportojnë dhe do të transmetojnë informacion të klasifikuar gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare ose në përmbushje të një veprimtarie në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”;

b) përcaktimi i rregullave, mbi bazën e të cilave veprohet për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit, për edukimin e sigurisë, inspektimet dhe të drejtën e ankimimit të individëve.”

Në nenin 2 të saj “Fusha e veprimit” parashikohet se:

“Rregullat për sigurimin e personelit zbatohen nga të gjitha ministritë, institucionet shtetërore, si dhe nga operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë palë në kontrata të klasifikuara.

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të njëjtën mënyrë ndaj të gjithë individëve që u nënshtrohen procedurave të verifikimit të sigurisë për t’u pajisur me “Certifikatë të sigurimit të personelit” për njohjen, prodhimin, ruajtjen, administrimin, transportimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare ose në përmbushje të një veprimtarie në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”.

Në nenin 4 “Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar” parashikohet se:

“Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm individët, që:

- a) sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i ministrisë/institucionit ose Oficeri i Sigurimit Industrial i Kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë;
- b) kanë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë;
- c) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”.”

Në vijim, në nenin 7 “Listat e funksioneve për njohjen e informacionit të klasifikuar” përcaktohet si më poshtë vijon:

“Ministritë dhe institucionet shtetërore të cilat, për shkak të veprimtarisë që kryejnë, prodhojnë informacion të klasifikuar ose gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera e përftojnë këtë kategori informacioni, kanë për detyrë të miratojnë dhe të dërgojnë me shkrim në DSIK:

a) listën e funksioneve organike që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të prodhuar nga institucionet shtetërore ose/dhe të përftuar në kuadrin e bashkëpunimit dy-ose shumëpalësh me shtete dhe organizata ndërkombëtare;...”

- **VKM nr. 312, datë 16.03.2011 “Për miratimin e rregullore “Për punën e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””**

Në Kreun e I-rë, parashikohet:

“1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është disiplinimi i procedurave dhe standardeve që garantojnë sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, gjatë procesit të krijimit, regjistrimit, qarkullimit, shfrytëzimit, shumëfishimit dhe arkivimit të tij.

Gjithashtu, kjo rregullore krijon një sistem në lidhje me:

a) krijimin, regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, në institucionet shtetërore;

b) kontrollin e marrjes, dërgimit, regjistrimit dhe shpërndarjes së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, ndërmjet institucioneve, në zbatim të ligjit dhe të vendimeve për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”;

c) evidentimin e shkeljeve që mund të ndodhin gjatë krijimit, regjistrimit, marrjes, dërgimit, shfrytëzimit, shumëfishimit dhe arkivimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

2. Pranë çdo ministrie apo institucioni shtetëror, i cili administron informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” funksionon Zyra e Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”. Në kuptimin e kësaj rregulloreje, zyra e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në rastet kur nuk funksionon si njësi strukturore e veçantë, përfaqëson personelin e protokoll/arkivit në ministri/institucione shtetërore që, përveç funksioneve të tyre, janë ngarkuar për punën me informacionin e klasifikuar që kjo ministri/institucion administron.

3. Zyra e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” mund të regjistrojë, qarkullojë, administrojë, shumëfishojë, arkivojë edhe informacion të paklasifikuar, por në regjistra të veçantë për informacionin e paklasifikuar.

4. Zyra e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, që ndodhet në ministri ose institucione shtetërore, përfshirë strukturat e tyre përbërëse, ndodhet në varësi të titullarit ose strukturës përkatëse, të cilët janë dhe përgjegjës për funksionimin e saj.

5. Shpërndarja për shfrytëzimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, bëhet me miratim të titullarit, vetëm tek ata punonjës, të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie” të përshtatshme dhe në bazë të parimit “nevojë për njohje”.”

Pra, referuar akteve normative ligjore e nënligjore të cituara më sipër rezulton se:

Avokati i Popullit është një institucion kushtetues që ka të drejtën kushtetuese e ligjore të njohjes së informacionit të klasifikuar. Kjo e drejtë buron dhe sanksionohet në nenin 20 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar dhe për shkak të përmbushjes së veprimtarisë dhe misionit kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, si dhe në kuadër të respektimit të parimit ligjor “nevojë për njohje”. Punonjësi i institucionit tonë z. Sotiraq Nushi, me detyrë Nd/Komisioner, është i pajisur me Certifikatën e Sigurimit të Personelit nga DSIK-ja,

respektivisht me nr. S/091/2003, lëshuar më 23.08.2019 deri më 22.08.2024, kategoria “Tepër sekret”.

Mosdhënia apo mosdërgimi i informacioneve/dokumenteve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në ngarkim të shtetasit B.L. të cilat administrohen në Kartotekën e Hetimit të Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, çmojmë se vjen të kundërshtim të plotë dhe të hapur me aktet normative në fuqi të cituara më sipër, dhe në veçanti me nenin 28 “Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar”, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Ju sjellim në vëmendje se ky nen, të cilin ju e referoni si bazë ligjore në përgjigjen dërguar institucionit tonë për mos dhënien e mos dërgimin e dokumenteve të kërkuara, bën fjalë për të drejtën e njohjes së informacionit të klasifikuar dhe jo për të drejtën apo detyrimin e institucioneve shtetërore për të mos dhënë këtë lloj informacioni.

Ne vlerësojmë se qëndrimi i mbajtur nga ana juaj duke kërkuar pajisjen tonë me autorizim nga Ministri i Brendshëm për vënien në dispozicion të materialeve në ngarkim të shtetasit B.L., të cilat gjenden në kartotekën për hetimin e krimeve në DVP Vlorë, **është haptazi i pabazuar në ligj**. Referuar gërmës “a”, të pikës 1 të nenit 28 të ligjit nr. 10/2023, rezulton se nuk parashikohet dhënia apo pajisja me autorizim të një punonjësi nga titullari i ministrisë/institucionit me qëllim që të ketë qasje me informacionin e klasifikuar. Ndërkohë çmojmë se ky qëndrim është rrjedhojë interpretimit jo të drejtë të kësaj dispozite. Atributin/tagrin e vlerësimit të kriterit të sigurimit të të drejtës së njohjes për shkak të detyrës që kryejnë, e ka titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit, në të cilin është i punësuar personi që do të njihet me informacionin e klasifikuar. Titullari i ministrisë/institucionit në këto raste është çdo titullar që për shkak të kryerjes së misionit/veprimtarisë kushtetuese e ligjore dhe nisur nga parimi ligjor “nevojë për njohje”, do të vlerësojë nevojën e pajisjes me CSP të punonjësve të tij që do të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar që prodhojnë, administrojnë dhe qarkullojnë organet e administratës publike. Pra, në rastin në fjalë, me titullar nuk kuptohet Ministri i Brendshëm, sikurse është përceptuar nga ana juaj, por Avokati i Popullit, i cili ia ka dhënë të drejtën e njohjes punonjësit të tij ndihmëskomisionerit z. Sotiraq Nushi që me bërjen e kërkesës tek autoriteti përkatës kompetent ish DSIK-ja (aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar-AKSIK) për pajisjen me CSP. Sipas akteve normative në fuqi, veçanërisht nenit 28/1/a të ligjit nr. 10/2023 dhe neneve 4 e 7 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, të cituara më sipër, sigurimin e të drejtës së njohjes me informacionin e klasifikuar nuk mund ta bëjë vetëm titullari i ministrisë/institucionit që prodhon, administron dhe qarkullon informacion të klasifikuar, por çdo titullar i ministrisë/institucionit që për shkak të veprimtarisë që kryejnë, prodhojnë informacion të klasifikuar ose gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera e përftojnë këtë kategori informacioni. Ata kanë për detyrë të miratojnë dhe të dërgojnë me shkrim në DSIK/AKSIK, listën e funksioneve organike që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të prodhuar nga institucionet shtetërore ose/dhe të përftuar në kuadrin e bashkëpunimit dy-ose shumëpalësh me shtete dhe organizata ndërkombëtare.

Në rastin në shqyrtim, veprimet e institucionit të Avokatit të Popullit dhe të punonjësit të tij që u paraqit në DVP Vlorë në datën 23.03.2023, janë në përputhje të plotë me aktet normative në fuqi, në përmbushje të detyrave funksionale institucionale dhe se nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për njohjen me dokumentacionin e klasifikuar si “Sekret shtetëror” që ky organ administron ndaj ankuesit B.L..

Ndërkohë ju sjellim në vëmendje se deri më tani, përveç këtij rasti të veçuar, bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe strukturat e saj vendore ka qenë shumë i mirë dhe se nuk na janë krijuar pengesa të tilla për njohjen me informacione të klasifikuara kur ka qenë e nevojshme.

Ky qëndrim shton dyshimet lidhur me administrimin e informacionit “Sekret shtetëror” në regjistrat manualë apo dosje si dhe në sistemin elektronik të strukturave të ndryshme të Policisë së Shtetit. Sipas këtyre informacioneve, në jo pak raste ndodh që hidhen informacione “kriminale” në sistem dhe ndonëse pas verifikimeve të bëra në vijim ka rezultuar që ato janë pa vlerë, pra nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur, apo ka kaluar periudha kohore e deklasifikimit, nuk reagohej për fshirjen apo bërjen anonime të tyre, sikurse parashikohet në legjislacionin përkatës në fuqi. Ne çmojmë se ky qëndrim sjell pasoja të ndryshme për shtetasit ndaj të cilëve është regjistruar ky lloj informacioni, si pengesa për të konkuruar për arsimim apo punësim në strukturat e administratës publike për të cilat kërkohet dhënia e vërtetimit të besueshmërisë nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit, etj.. Sqarojmë se raste të kësaj natyre institucioni ynë ka shqyrtuar edhe më parë. Me ndërhyrjen tonë, pas një komunikimi të mëhershëm shkresor, është bërë korigjimi i të dhënave të shtetasit A.A. e mandej ai është pranuar në Akademinë e Sigurisë. (Shkresa e fundit e dërguar nga ana jonë organit tuaj lidhur me këtë rast është me nr. K2/A5-13 prot., datë 24.05.2022).

Në vlerësimin tonë një fenomen i tillë është jo vetëm me pasoja të rënda në dëm të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, por njëkohësisht është edhe i kundërligjshëm. Nga ana tjetër, krijohet mundësia e përdorimit të këtij informacioni nga punonjës policie të caktuar për qëllime jo të ligjshme ndaj shtetasve.

Qëndrimi refuzues i mbajtur nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë dhe së fundmi edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka sjellë si pasojë pengimin e institucionit të Avokatit të Popullit për të kryer misionin kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave ligjore të shtetasve.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ***si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend***, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi të shpejtë, objektiv dhe profesional nga organet tuaja, duke analizuar shkaqet, nxjerrjen e përgjegjësiive konkrete

dhe mos përsëritjen e rasteve të tilla që krijojnë premisa për shkelje ligjore dhe ndërkohë pengojnë funksionimin normal të institucionit tonë.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga strukturat përkatëse për dërgimin e informacionit dhe të dokumentacionit lidhur me shtetasin B.L..
2. Marrjen e masave të nevojshme për të analizuar në mënyrë të thellë, me objektivitet dhe me profesionalizëm të shkaqeve të cilat kanë sjellë këtë qëndrim refuzues ndaj institucionit të Avokatit të Popullit.
3. Marrjen e masave të nevojshme për fillimin e procedurës administrative ndaj drejtorit të DVP Vlorë z. Ermal Muçaj për refuzim të bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 22/1 të ligjit organik *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar.
4. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të rasteve të refuzimit për bashkëpunim të drejtuesve të strukturave të Policisë së Shtetit me institucionin e Avokatit të Popullit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi